

Dita e djeshme u bombardua me lajmin për shugurimin e katedrales “Nëna Terezë”, ndërsa në këtë ngjarje nuk munguan as presidenti i vendit dhe personalitet të tjera politike.

Por një detaj mjaft shokues, i cili me gjasë “nuk është vërejtur” nga mediumet – portalet, është përdhosja e flamujve kombëtar dhe shtetëror pikërisht në këtë ngjarje.

Ndërsa presidenti i vendit përzgjedhë fjalët më të artikuluar për të përshkruar atdhedashurinë, veprat flasin si më së miri.

Në një qoshe, të hedhur në tokë pranë statujës së Nënës Terezë, qëndrojnë të hedhur dhe të zhburosur dy flamujt, ai i shtetit të Kosovës dhe ai i shqiptarëve.

Ironia e tërë kësaj rrumbullakësohet me pretendimet se “nuk ka pëlhurë që mbulon lavdinë tonë”. Me sa duket, askush nuk e ka parë se pikërisht pëhura që përfaqëson shtetet e shqiptarëve po hidhet përtoke, po zhvlerësohet dhe po përdhohet. President, ku mbeti lavdia?
/MESAZHI/